

MINISTRIA E SHËNDETËSISË E KOSOVËS  
QENDRA PËR ZHVILLIMIN E MJEKËSISË  
FAMILJARE E KOSOVËS



PROGRAMI I EDUKIMIT  
SPECIALISTIK PASDIPLOMIK  
NË MJEKËSI FAMILJARE

*Tetor 2007, Prishtinë, KOSOVË*

PROGRAMI I EDUKIMIT SPECIALISTIK PASDIPLOMIK  
NË MJEKËSI FAMILJARE NË KOSOVË

Ditari i punës  
*për specializantin*

*Emri dhe mbiemri:*

*Data e fillimit të ESP në MF:*

..... / ..... / .....

Ky ***Ditar i punës për specializantin*** do të përdoret në Programin e Edukimit Specialistik Pasdiplomik në Mjekësi Familjare dhe është i mbrojtur nga Ministria e Shëndetësisë e Kosovës / Qendra për Zhvillimin e Mjekësisë Familjare, Botimi i parë 2004 Prishtinë, KOSOVE  
© ***QZHMF / MeSH, 2004***  
**www.cdfmk.org & www.amfk.org**  
*Designed by: dr.vali © 2002-2004*

***Hartuesit e Ditarit të punës:***

***Komiteti Specialistik:***

Dr.Genc Ymerhalili  
Dr.Valdet Hashani  
Dr.Arbëresha Nela-Turjaka  
Dr.Illir Rrecaj  
Dr.Linda Çarkaxhiu

***Bashkëpunëtorët ndërkombëtarë:***

Dr. Bob Hedley  
Dr.Vladimir Gusmari  
Dr. Tom Garrett  
Dr. Huw Morgan  
Dr. Graham Rawlinson

*Botimi i pare: 2004,*  
*Ribotimet tjera: 2005, 2006*  
*Botim i korigjuar: 2007*  
Prishtinë, KOSOVE

## Përmbajtja

Për specializantin	4
<i>Për specializantin</i>	4
Për Trajnuesin	6
<i>Për trajnuesin</i>	6
Aneksi 1	8
Aneksi 2	10
<i>Përpilimi i konsultimeve për ditarin e punës për specializantin 10</i>	
Moduli 1	13
<i>Orientimi në Mjekësinë Familjare</i>	13
Moduli 2	22
<i>Shëndeti publik</i>	22
Moduli 3	28
<i>Emergencat më të Shpeshta në Kujdesin Parësor Shëndetësor -</i>	
<i>KPSH</i>	28
Moduli 4	34
<i>Shëndeti i fëmijëve dhe adoleshentëve</i>	34
Moduli 5	38
<i>Sëmundjet kronike</i>	41
Moduli 6	48
<i>Shëndeti mental</i>	48
Moduli 7	54
<i>Shëndeti i mesbënjëve</i>	54
Moduli 8	60
<i>Shëndeti i femrave</i>	60
Moduli 9	67
<i>Shëndeti i të moshuarve</i>	67

Moduli 10	74
<i>Të menduarit kritik dhe hulumtimet</i>	74
Module 11	77
<i>Menaxhmenti shëndetësor</i>	80

## LISTA KONTROLLUESE PËR PRAKTIKËN HOSPITALORE 81

<i>Dermatologji</i>	86
<i>Hundë, vesh dhe fytyrë</i>	87
<i>Planifikimi familjar</i>	89
<i>Venerologji</i>	89
<i>Kujdesi për të moshuarit</i>	90
<i>Mjekësia interne</i>	92
<i>Obstetrikë dhe gjinekologji</i>	94
<i>Oftalmologji</i>	95
<i>Ortopedia</i>	96
<i>Pediatri</i>	97
<i>Psikiatri</i>	99
<i>Reumatologji</i>	100
<i>Diagnozat kirurgjike</i>	101

## Për specializantin

### Hyrje

***Mirë se erdhët në Mjekësi Familjare. Shpresojmë se do të kënaqeni me skemën tonë të Programit të Edukimit Specialistik Pasdiplomik tre vjeçarë dhe interaksionin me ambientet e veçanta mësimore dhe trajnuese. Kjo skemë është e bazuar në personin dhe konsiston në:***

- Konsultimin tuaj me pacientët dhe familjet
- Qendrën tuaj mësimore familjare
- Spitalin
- Trajnuesin dhe mentorin tuaj
- Juve
- Dhe këtë ditar pune

***Ky ditar pune është i dizajnuar për ju për t'ju paraqitur objektivat mësimore esenciale të pesë sferave mësimore:***

- Shkathësitë e komunikimit dhe raportin mjek-pacient
- Njohuritë dhe shkathësitë profesionale të aplikuara si p.sh: ekzaminimi fizik dhe shkathësitë procedurale, gjendjet mjekësore shëndetësore, vendimmarrja

- Shëndeti i popullsisë dhe konteksti i mjekësisë familjare
- Roli profesional dhe etik, si p.sh: standardet, vetë-vlerësimi, roli i mësimdhënësit, hulumtimi, vetë-kujdesi, rrjetat (qarqet)
- Dimensionet organizative dhe ligjore, si p.sh: teknologjia informative, shenimet (regjistrat), raportimi, sekretet mjekësor, menaxhmenti i qendrës së mjekësisë familjare në secilin prej njëmbëdhjetë moduleve:

Nr.	Modulet e ESP në MF	Muajt
1.	Orientimi në Mjekësinë Familjare	2
2.	Shëndetësi publike	2
3.	Emergjencat më të shpeshta në KPSH*	4
4.	Shëndeti i fëmijëve dhe adoleshentëve	4
5.	Sëmundjet kronike	6
6.	Shëndeti mendor	4
7.	Shëndeti i meshkujve	2
8.	Shëndeti i femrave	4
9.	Shëndeti i të moshuarve	2
10.	Të menduarit kritik dhe hulumtimi	4
11.	Menaxhmenti shëndetësor	2

***Çelësi i mësimin të të rriturve është reflektimi mbi përvojën. Përmes kësaj ju zhvillonit fuqitë tuaja konceptuale dhe kritike të të menduarit dhe i aplikoni të njejtat në punën e përditshme.***

*\*Kujdesi Parësor Shëndetësor*

*Prandaj, ne ju kemi siguruar hapësirë për shënimin e objektivave tuaja personale të mësimit. Ne kemi dizajnuar një ditar pune (reflektiv) për ju që t'i shenoni çdo ditë kontaktet tuaja me pacientë në atë mënyrë që t'u ndihmojë strukturimin e mësimit tuaj nga kjo eksperiencë. Ditari i punës (reflektiv) është konfidencial për ju andaj ju mund ta shfrytëzoni në mënyrën tuaj dhe mund t'u tregoni tjerëve sipas dëshirës. Ju do të diskutoni me trajnuesin tuaj në fund të çdo modulit ku edhe do të vlerësoheni nga ana e Trajnuesit tuaj për rastet e shënuara në Ditarë apo edhe në letër shtesë të cilat duet ti bashkangjitni në Ditarin tuaj .*

*Janë dhënë fletë të zbrazëta për shenimet tuaja personale në stilin tuaj të preferuar si dhe lista artikujsh për t'ju udhëzuar derisa hulumtoni situata të caktuara, gjendjet dhe procedurat diagnostike biomjekësore. Këto lista artikujsh nuk janë të plota andaj ju dhe trajnuesi juaj do të duhej t'i plotësonit. Mund të jetë e pamundur që ju t'i shihni të gjitha procedurat dhe gjendjet e rradhitura, por si rregull i përgjithshëm ju do të duhej t'i ndjekni ato. Trajnuesi juaj mund të dëshiroj që t'i shiqoj për të kontrolluar mësimin tuaj.*

*Ne do të sygjeronim që të kontrolloni njohuritë dhe shkathhtësitë tuaja në fillim duke shfrytëzuar një klasifikues të kompetencës prej 1 deri në 3 dhe do të dëshironim që ju këtë ta diskutoni me trajnuesin apo mentorin tuaj dhe gjithnjë të kërkonit këshillë. Ju këtë libër mund ta shfrytëzoni edhe për reflektim mbi leximin dhe diskutimet tuaja me kolegë dhe anëtarë të ekipit tuaj.*

*Shpresojmë se do të kënaqeni gjatë kohës së kaluar me pacientë dhe me ekipet e mjekësisë familjare dhe të specialistëve. Do të theksojmë rëndësinë e përkujdesjes për veten tuaj si edhe për shëndetin e të tjerëve. Disa do të thonin që menaxhimi personal*

*është çelës për menaxhimin në përgjithësi. Gjithashtu është çelës për menaxhimin e ndryshimeve dhe ju do të përjetoni shumë ndryshime! Pas tre vjetëve ju do të ndjehemi shumë më me vetëbesim për përballimin me shumë gjëra të pasigurta dhe paradoksale të praktikës së përgjithshme mjekësore dhe do të bëheni një profesionist i pavarur.*

*Së fundi, mendoni në mënyrë kritike dhe mbani mendjen të hapur!*

## Për trajnuesin

### Hyrje

***Ky ditar pune është dizajnuar për trajnimin tuaj si udhërrëfyes drejtë Edukimit Specialistik Pasdiplomik tre vjeçarë. Derisa shpresojmë se ju do të pajtoheni, ky është një mjet reflektiv për themelimin e shprehive të mësimit të përrjetshëm. Si i tillë ka nevojë për evaluim të rregullt për të përcaktuar nëse është:***

- Efektiv
- Adekuat
- Efikas

***Prandaj, jini të lirë të komentoni në Qendrën për Zhvillimin e Mjekësisë Familjare, pranë Komitetit Specialistik për Mjekësi Familjare ashtu që ata të mund t'i sygjerojnë ndryshimet Bordit për Edukim Specialistik Pasdiplomik dhe të rekomandojnë revizion. Në formën aktuale të tyre, secili modul përmban elementet në vijim:***

- Një përmbledhje të objektivave mësimore dhe të sjelljes të bazuara në planprogram
- Një listë artikujsh të temave të sygjera (modulet klinike)
- Një ditar reflektiv për t'i ndihmuar specializantit që t'i nxjerrë objektivat mësimore nga takimet me pacientë apo nga literatura

- Një faqe për shkrimin e objektivave
- Një faqe për komente të hapura
- Një listë artikujsh për vlerësimin e shkathtësive

***Konsultimi me kolegë dhe me specialistë fuqishëm rekomandonte që pronësia e elementeve reflektive të ditarit të punës do të mbetej me specializantit. Kjo siguron që specializanti të jetë i aftë e i sigurt dhe t'a pyes vetëveten në mënyrë kritike dhe të shkruaj përgjigje dhe komente në formë reflektive. Në statet e hershme të edukimit specialistik këto mund të jenë në formë të tillë që specializanti mos të ketë ndjenjë të vetëbesimit për këmbimin e tyre. Është me rëndësi që të mos inhibohet procesi i të menduarit kritik, analitik dhe shprehja, një shprehje për zhvillimin e së cilës nevojitet kohë. Specializantë të ndryshëm, këtë e zhvillojnë me shpejtësi të ndryshme.***

***Deklaratat në vijim mund t'i konsideroni si ndihmesë. Ato dolën prej procesit të konsultimit i cili rezultoi në përpilimin e këtij ditarit të punës.***

***Reflektimi është qëllimi dhe ditarit i punës është mjeti për promovimin e tij.***

***Prandaj, ditarit i punës është i natyrës formative; vlerësimi formativ në formë të reflektimit të përqëndruar në pacientin dhe të bazuar në probleme. Kjo bëhet në formë të shkruar apo të shënimeve të cilat mund të nxisin diskutimin ndërmjet specializantit dhe trajnuesit.***

*Një dialog ndërmjet trajnuesit dhe specializantit do të mund të rrjedhte kështu:*

- Kënd/Çka keni parë?
- Si e keni përkufizuar problemin?
- Çfarë keni bërë?
- A pati sukses? Pse?
- Çfarë do të bëni tani?

*Specializanti nxitet në intervistë një-me-një për t'u përgjigjur në këto pyetje hulumtuese të trajnuesit.*

*Alternativisht nëse ditari i punës dorëzohet për lexim nga ana e trajnuesit apo vlerësuesit, logjika e shkruar duhet të jetë qartësisht e gatshme t'u përgjigjet këtyre pyetjeve.*

*Kontributi i ditarit të punës në mësim dhe zhvillim profesional vështrohet përmes pyetjes:*

A e ka shfrytëzuar specializanti ditarin në mënyrë reflektive apo thjehtë për përshkrim?

*P.sh: procesi i vlerësimit është “intervistimi i ditarit të punës” për deklarata dhe komente të shkruara në përgjigje të pyetjeve.*

*Pjesët me lista artikujsh janë të përshtatshme për specializantët që t'a ndajë me trajnuesin. Tabela e vlerësimit të shkathtësive për komunikim është në shfrytëzimin tuaj si edhe të specializantit. Sygjerohet që këto lista të jenë të vetë-vlerësuara duke shfrytëzuar shkallën e konfidencës me vlera 1 deri 3 dhe të vlerësuara objektivisht për konfidencë në raste të ndara kur ju ndërmerrni vlerësimin formativ në fund të modulit.*

*Shpresojmë që do të kënaqeni duke u ndihmuar mësimin nga përvoja të specializantëve si dhe do ta konsideroni këtë si ndihmesë.*

# Përpilimi i ditarit të punës

*Specializantët në Programin e Edukimit Specialistik Pasdiplomik (në Mjekësi Familjare) si parakusht kanë një regjistër progresiv dhe rigoroz akademik të përvojës për zhvillimin e njohurive, shkathtësive dhe qëndrimeve.*

*Në kushte ideale ditari i punës do të duhej të ishte:*

- Miqësor për specializantë
- Miqësor për trajnues
- Specifik për modulën
- Progresiv dhe formativ
- Rigoroz
- I formatit të përshtatshëm

*Qëllimi i ditarit të punës mund të mendohet të jetë më shumë vlerësim subjektiv se sa vlerësim p.sh: duke inkurajuar zhvillimin e vashdueshëm personal-profesional, si shprehja e praktikës reflektive në mësimin e përjetshëm. Në kuptimin arsimor nëse bëhet vlerësimi i studentit, ky do të ishte një dokument i vlerësimit formativ, duke e lënë modin sumativ të vlerësimit për metoda më objektive dhe të evaluara.*

## *Miqësor për specializantë*

- Kuptohet lehtë
- Spjegime të thjeshta
- Interaktiv
- Reflektiv
- Faqe të zbrazëta për komentim të shkurtër
- Përshtatshmet e problemeve klinike dhe menaxhimi (pacientët e vetë)

## *Miqësor për trajnues*

- I standardizuar
- Shfrytëzimi nga trajnues/mentorë të ndryshëm
- Relevant për modul
- Faqe përmbledhëse për komente dhe vlerësim formativ

## *Specifik për modul*

- Përmbajtja e esencialeve të planprogramit
- Objektiva mësimore personale
- Objektiva mësimore të nevojshme
- Regjistra rastesh relevante për modul
- Vlerësim formativ për modul relevant

***Progresiv***

- Demonstrim i përvojës së akumuluar
- Demonstrim i përparimit
- Specifik për fushat që kërkojnë përmirësim
- Klasifikime verbale/rezultate numerike
- Faqe përmbledhëse

***Rigoroz***

- Regjistër akademik i të arriturave
- Diskriminues
- Evaluativ
- Kompetencë e demonstrueshme (përvoja dhe shkathhtësitë p.sh: shiqimi dhe bërja)
- Vetë-vlerësim
- Vlerësim objektiv

***Format i përshtatshëm***

- jo i formës së dosjeve për rafte

- formë kopertine
- mundëson futjen e fletëve shtesë
- të mund të ri-shtypet (kopje në letër dhe elektronike)
- i shtypur në të dy anët e fletëve
- formati A5
- faqe të zbrazëta për komentim të shkurtë

*Reflektimi është qëllimi dhe ditari i punës është mjeti për promovimin e tij.*

# Përpilimi i konsultimeve për ditarin e punës për specializantin

## *Komiteti Specialistik jep sygjërimet në vijim:*

### *Vlerësimi*

- Pronësia e kopjeve të vlerësimeve nga ana e specializantëve
- Nevoja për mbajtjen e vlerësimeve dhe vetëvlerësimeve në ditar të punës sipas moduleve
- Mbajtja e vlerësimeve sumative si e veçantë. (me A-D, trajnuesit të kalibrojnë notimin e tyre)

### *Ditari reflektiv*

- Deri në 10 anamneza (histori) rastesh për modul, proporcionale me madhësinë e modulit
- Përshkrimi i anamnezave të rasteve të temave/gjendjeve të caktuara klinike
- Inkurajimi i përcjelljes
- Të zëvendësohet me ndonjë gjendje alternative nëse ajo e përshkruara nuk është parë

- Dhënia e shembujve të shkrimit të mirë reflektiv në fillim të secilit ditarë të modulit, duke përfshirë edhe SOVP (*Subjektiv, Objektiv, Vlerësim, Planifikim*) - SOAP (*Subjective, Objective, Assessment, Planning*)

### *Objektivat mësimore*

- Qëndrojnë me planprogramin, p.sh: shif Modulet në vazhdim
- Trajnuesit të përshkruajnë
- Adaptimi për nevojat e specializantëve
- Trajnuesit të shfrytëzojnë dizajne kreative për ushtrimet praktike
- Inkurajimi i specializantëve për caktimin e objektivave mësimore për pjesën tjetër të modulit pas vlerësimit formativ për inkurijimin e mësimit të përgjeshëm

### *Pilotimi*

### *Konsideratat e ndërlidhura*

- Një përmbledhje shumë e shkurtër nevojitet për secilin modul me informata të gjerësishme në Doracakët e pjesëmarrësve dhe të mësimdhënësve.
- Vlerësimi apo vlerësimi subjektiv të jenë sa më formativ për të inkorporuar regjistrimet e kompetencës
- Një libër për të gjitha modulet për të mundësuar vetë-vlerësimin e vazhdueshëm dhe deponimin e besueshëm.
- Kopje të vlerësimeve formative modulare mund të merren nga trajnuesit
- Notimi (klasifikimi) mund të shmanget në pah të subjektivitetit të raportit kolegial trajnues-specializant në disa raste dhe pasaktësia e kalibrimit ndërmjet trajnuesëve.
- Zhvillimi i shkathtësive të komunikimit udhëheqet më së miri përmes përsëritjes së konsultimeve sesa kalimi/dështimi i atyre të dorëzuara.
- Praktika reflektive duket të jetë qëllimi kryesorë i ditarit të punës.

***ORARI I EDUKIMIT SPECIALISTIK PASDIPLOMIK TREVJEÇAR  
NË MJEKËSI FAMILJARE I NDARË NË VITE DHE MODULE  
(KOHËZGJATJA E MODULEVE E SHPREHUR NË MUAJ/VIT)***

***VITI 1:***

2/12 QTMF Hyrje. Orientimi në Mjekësinë Familjare -1 ditë (javë) Ligjëratat Qëndrore/ QZHMFK/, / 2 ditë (javë) në QTMF

2/12 Shëndetësi publike, -1 ditë (javë) Ligjëratat Qëndrore/ QZHMFK/ 1 ditë (javë) në IRSHP (IKSHP) + 1 ditë (javë) në QTMF

4/12 Emergjencat më të shpeshta në KPSH, -1 ditë (javë) Ligjëratat Qëndrore/ QZHMFK/, 1 ditë (javë) (nga ora 07-15.00) në javë në spital + 1 ditë (javë) në QTMF

4/12 Shëndeti i fëmijëve dhe adoleshentëve, -1 ditë (javë) Ligjëratat Qëndrore/ QZHMFK/, 1 ditë (javë) (nga ora 07-15.00) në javë në spital + 1 ditë (javë) në QTMF

***VITI 2:***

6/12 Sëmundjet kronike, -1 ditë (javë) Ligjëratat Qëndrore/ QZHMFK/, 1 ditë (javë) (nga ora 07-15.00) në javë në spital + 1 ditë (javë) në QTMF

4/12 Shëndeti mental, -1 ditë (javë) Ligjëratat Qëndrore/ QZHMFK/, 1 ditë (javë) (nga ora 07-15.00) në javë në spital (apo Qendrat e shëndetit mental në komunitet) + 1 ditë (javë) në QTMF

2/12 Shëndeti i meshkujve, -1 ditë (javë) Ligjëratat Qëndrore/ QZHMFK/, 1 ditë (javë) (nga ora 07-15.00) në javë në spital + 1 ditë (javë) në QTMF

***VITI 3:***

4/12 Shëndeti i femrave, -1 ditë (javë) Ligjëratat Qëndrore/ QZHMFK/, 1 ditë (javë) (nga ora 07-15.00) në javë në spital(Obs/Gyn) + 1 ditë (javë) në QTMF

2/12 Kujdesi për të moshuarit, -1 ditë (javë) Ligjëratat Qëndrore/ QZHMFK/, 1 ditë (javë) (nga ora 07-15.00) në javë në spital + 1 ditë (javë) në QTMF

4/12 Të menduarit kritik dhe hulumtimi -1 ditë (javë) Ligjëratat Qëndrore, / QZHMFK/+ 2 ditë (javë) në QTMF

2/12 Menaxhmenti shëndetësor -1 ditë (javë) Ligjëratat Qëndrore, / QZHMFK/+ 2 ditë (javë) në QTMF

***Përmbledhje:***

***Ekziston një pajtim i gjerësishëm për dizajnimin e ditarit të punës si mjet i orientuar në specializantin për modulet e reja të trajnimit profesional tre vjeçar (ESP në MF). Spjegimet shtesë dhe shembujt model të shkrimit reflektiv do të duhej të theksonin qëllimin kryesor si***

***1. reflektimi dhe***

***2. regjistrimi i përvojës si bazë për***

***3.vetë-vlerësimin-formativ.***

***Format e vlerësimit të cilat do të përdoren gjatë tre viteve të ESP\* në Mjekësinë Familjare janë:***

.....

- 1. TEST Formativ me PZSH\*\*, në fund të vitit të parë dhe në fund të vitit të dytë , bazuar në Modulet e realizuara paraprakisht, përderisa***
- 2. TESTI Sumativ në fund të vitit të tretë me PZSH dhe PPMM\*\*\*, si tesdt përmbledhës nga Materialet e Module të tre viteve të ESP në MF\*\*\*\****
- 3. Tandem –Konsultim, një në fund të çdo Moduli***
- 4. Videoinçizim, nga një në fund të çdo viti (1-3)***
- 5. Ditari i punës, për demobnstrimin e shkathtësive praktike të dorëzohet në fund të vitit të tretë, por të kontrollohet pas çdo Moduli nga trajnuesi përgjegjës.***
- 6. Auditi të dorëzohet në fund të vitit të tretë (së paku dy muaj para provimit final)]***

.....

*\*Edukimit Specialistik Pasdiplomik*  
*\*\* Pyetjet me Zgjedhje të Shumëfishta*  
*\*\*\*Pyetjet me Përgjigjen Më të Mirë*  
*\*\*\*\* Mjekësia Familjare*

# Orientimi në Mjekësinë Familjare

*Moduli 1:*

Emri: \_\_\_\_\_

Data:   filloi: \_\_\_\_\_   përfundoi: \_\_\_\_\_

***Mirë se erdhët në “Mjekësinë Familjare”. Ky është moduli i parë prej gjithsej njëmbëdhjetë moduleve të programit të edukimit specialistik pasdiplomik tre vjeçar. Ky modul do të zgjatë dy muaj. Për të ju ndihmuar të vendoseni në kontekstin e disiplinës së praktikës familjare ju lutemi referohuni në planprogramin për hollësitë e të gjitha moduleve duke përfshirë edhe pesë sferat e mësimi:***

- A. Shkathhtësitë e komunikimit
- B. Njohuritë dhe shkathhtësitë profesionale të aplikuara
- C. Shëndeti i popullatës dhe konteksti i praktikës familjare
- D. Roli profesional dhe etik
- E. Dimensionet organizative dhe ligjore.

- Konceptet dhe filozofitë që mbështesin kujdesin primar dhe të përonit si tërësi
- Metodot e punës me pacientë në mjedise komuniteti
- Rolet e mjekëve dhe infermierëve në praktikën familjare

***Në mjekësi familjare si disiplinë të veçantë me trupin e saj të njohurive, metodologjisë dhe të hulumtimit mund të fillohet me deklaratën në vijim para përkufizimit të objektivave të saj:***

Fushat e tjera veten e përkufizojnë sipas përmbajtjes, sëmundjeve, sistemeve të organeve apo teknologjisë. Klinikistët e fushave tjera krijojnë raporte me pacientë, por në mjekësinë familjare raporti zakonisht i paraprinë përmbajtjes. Ne i njohim njerëzit para se të dijme sëmundjen e tyre. Natyrisht se është e mundur të përkufizohet përmbajtja e praktikës familjare e bazuar në gjendjet e zakonshme që shfaqen te mjekët familjarë në kohë dhe vend të caktuar. Por duke folur më rigorozisht, përmbajtja për një mjek të caktuar është çkado që pacienti i tij mund të ketë.

(McWhinney)

***Kjo deklarata si gurëthemel të saj ka qasjen e përqëndruar në pacientin.***

***Ajo e pranon centralitetin e raportit mjek-pacient dhe mjekësinë familjare e përshkruan nga këndvështrimi gjithëpërfshirës; duke theksuar rëndësinë e kontekstit.***

***Është më parë makroskopike (se sa reduktuese) dhe dallon që tërësia është më e madhe se sa përmbledhja e pjesëve individuale. prandaj, ju do të keni nevojë që të:***

- Integroni konceptet kryesore dhe parimet e mjekësisë familjare në rolin tuaj si mjekë profesional
- Reflektoni mbi mënyrën e aplikimit të këtyre në secilën prej sferave prioritare të mësimin
- Jeni fleksibil, t'i përshtateni ndryshimit dhe të përdorni rolin potencial tuaj si agjent terapeutik në reportin mjek-pacient
- Zhvilloni shkathtësitë tuaja profesionale përmes zhvillimit të shprehive të mësimin të përzetshëm

***Këtu janë dhënë disa objektiva të bazuara në sferat e planprogramit. Shfrytëzoni ditarin reflektiv në fund si mjet për regjistrimin e përvojës suaj dhe për caktimin e objektivave tuaja personale të bazuara në pacientët që shihni:***

***Shkathtësitë e komunikimit dhe raportit mjek-pacient***

- *reflektimi dhe eksplorimi mbi natyrën e raportit ndërmjet pacientit dhe mjekut*
- *kuptimi dhe shfrytëzimi i potencialit terapeutik të reportit mjek-pacient*
- *njohja e pacientëve si partnerë, duke pranuar autonominë e tyre dhe rolin integral në procesin e kujdesit shëndetësor*
- *identifikimi i rolit të mjekut familjar në procesin e kujdesit shëndetësor dhe përgjegjësisë së tyre ndaj pacientëve, familjeve dhe komunitetit*
- *përshkrimi spektrit të sjelljes së sëmundjes*

***Roli profesional dhe etik  
Ndërmerr:***

- vetë-vlerësim subjektiv kritik mbi jetën tuaj (dhe të mjekëve tjerë familjarë) profesionale për zhvillimin e një qasjeje të baraspeshuar me jetën personale,

***thekson:***

- se koha është një mjet i rëndësishëm për përkufizimin dhe menaxhimin e problemeve
- rëndësinë e vetë-auditit dhe praktikave të mësimit të përrjetshëm
- rolin e mjekut familjar në sistemin shëndetësor të Kosovës
- si parimet e barazisë theksojnë rolin e mjekut familjar si një agjent për përmirësimin e shëndetit të individëve dhe të komunitetit
- nevojën për të qenë proaktiv në zhvillimin e politikave për shërbimet shëndetësore.

*Disa parime të përgjithshme për t'u ndihmuar në mësimin e këtij dhe moduleve vijuese:*

*Mësimi i përrjetshëm dhe reflektiv*

*Ky modul është bërë në bazat që reflektimi (mendimi, konsiderimi, diskutimi, shkrimi) shpiten deri te cikli i vazhdueshëm. Ai kërkon përvojë konkrete (reale) si p.sh. kohë e kaluar me pacientë, kuptimi dhe plotësimi i nevojave të tyre. Në këtë proces ne zhvillojnë nevoja mësimore dhe u referohemi dëshmiave dhe teorisë ekzistuese dhe formulojmë tonat përmes procesit të konceptualizimit abstrakt. Pastaj ne këto i aplikojmë në kujdesin për pacientë (eksperimentimi aktiv është zhargon arsimor e jo mjekësor!) dhe përfitojmë përvojë të re mbi të cilën ne mund të reflektojmë. Për të bërë këtë, është i domosdoshëm zhvillimi i mëtutjeshëm i shkathtësive tona jo vetëm prej leximit dhe shkrimit por prej mendimit kritik dhe hulumtimit. Ne kemi nevojë të jemi përgjegjës për pacientët tonë përmes demonstrimit të këtyre disiplinave, p.sh. me auditim të menaxhimit tonë klinik. Shumë mjekë, këtë cikël mësimi dhe të punës e konsiderojnë se e rritë kënaqësinë e tyre dhe shpie drejtë jetës profesionale e cila është përmbushëse.*

*Portofolet*

*Me mbledhjen e ditarëve të punës për njëmbëdhjetë modulet e programit të edukimit specialistik pasdiplomik tre vjeçar ju jo*

*vetëm që do të jeni të aftë të bëni vetë-vlerësimin, por edhe do të jeni të hapur për rishqyrtimin nga trajnuesit tuaj në një vlerësim objektiv (inkurajim dhe udhëheqje dhe prova të kompetencës). Sygjerohet që këto shënime t'i mbani në formë të dosjes (në letër apo më mirë kompjuterike) dhe t'u shtoni atyre mjetet e mësimit duke përfshirë edhe ditarët tuaj të punës (reflektiv) të pacientëve që ju i takoni dhe planin mësimor personal (objektivat mësimore të caktuara dhe të arritura me kohë). Ju mund të shtoni edhe shenimet tjera të dizajnit tuaj si dhe dokumente vlerësimi. Pas regjistrimit të specializimit tuaj do të keni nevojë t'i mbani këto të azhurnuara për ri-validim.*

*Vëreni që vetëbesimi (subjektive) dallon shumë prej kompetencës. Kjo e fundit kërkon vlerësimin objektiv.*

*Ditari reflektiv*

*Gjithashtu është shtuar ditari reflektiv për shërbimin tuaj. Sygjerohet që t'i plotësoni së paku katrorët numër 1 dhe 2 për ata pacientë të cilët i regjistroni dhe të gjitha katrorët për së paku pesë pacientë.*

*... dhe të menduarit pozitiv!*

*Shpresojmë se do të inkurajoheni dhe do të ngazëlleshni nga ardhmëria e studimit dhe praktikimit të mjekësisë jo vetëm me shkathtësitë tuaja biomjekësore por edhe në kontekstin e nevojave fiziologjike, emocionale, sociale dhe shpirtërore të pacientëve tonë dhe të familjarëve e komuniteteve. Sygjerohet t'a shfrytëzoni rastin e këtij moduli për të shiquar në menaxhimin e shëndetit tuaj si edhe të tjerëve dhe për zhvillimin e punës ekipore me tjerët (duke i përfshirë edhe profesionet e ndërlidhura me mjekësinë dhe pacientët tonë). Ekipet, ngjashëm me automobilin, kërkojnë mirëmbajtjen e tyre, por si edhe familjet janë edhe grupe të personave të plotë. Ju keni hyrë në një fushë të punës së ngarkuar!*



Ditari reflektiv (emri)	Data:	Data:
<b>Kontakti me pacientë:</b> (në praktikën time) Shfrytëzo shifra ose initiale	Hera e parë: _____	Përcjellja: _____
<b>Anamneza e shkurtër e problemeve:</b>		
_____		
_____		
<b>Gjetjet pozitive në ekzaminim:</b>		
_____		
_____		
_____		
<b>Problemet e identikuara:</b>		
	1.	_____
	2.	_____
	3.	_____
	4.	_____
<b>Menaxhimi im:</b>		
_____		
_____		
_____		
<b>Çka duhet të di?</b> (referenca/përmbledhje e dëshmive/informatat; lidhshmëria mes pacientit tim dhe teorisë)		
	6)	_____
	7)	_____
<b>Objektivat mësimore</b>	8)	_____
	9)	_____
	10)	_____
<b>Çka kam mësuar?</b> (rezultati i përvojës sime)		
_____		
_____		
_____		
_____		

Ditari reflektiv (emri)	Data:	Data:
<b>Evalumi:</b> (gjatë ishte vlera e mësimit tim? Për pacientin? P.sh: a ka ndryshuar menaxhimi im?)		
_____		
_____		
_____		
_____		
_____		
<b>Dëshmi të ndryshimeve të praktikës sime:</b> (p.sh: shkathësi të reja)		
	Data:	_____
_____		
_____		
_____		
_____		

Vlerësimi i SHKATHTËSIVE në mjekësi familjare		Data Vetë (1-3)	Data Mbikqyrësi (1-3)
<b>Diagnostikimi</b>	1) Shkathtësi të komunikimit (verbal, jo-verbal)	_____	_____
	2) Dallon problemet më të shpeshta fizike psikologjike	_____	_____
	3) Përfshinë idetë, brengat, pritjet e pacientit	_____	_____
	4) Njohuri dhe shkathtësi për t'u marrë me ngjarje jetësore	_____	_____
	5) Ekzaminon çdo organ dhe sistem me zotësi	_____	_____
	6) Ekzaminon me konsiderim adekuat	_____	_____
<b>Menaxhimi i pacientit</b>	7) Zgjedhë menaxhimin adekuat	_____	_____
	8) Diagnostikon dhe i këmben opcionet menaxhuese	_____	_____
	9) Kujdes dhe përkrahje adekuate për pacientë dhe familjarë	_____	_____
<b>Gjykimi klinik</b>	10) Kryen ekzaminimin adekuat	_____	_____
	11) Prioritarizon situatat urgjente klinike	_____	_____
<b>Shkathtësi organizimi</b>	12) I vetëdijshëm për kufizimet e veta	_____	_____
	13) I aftë për menaxhimin e kohës së tij, prioritarizon	_____	_____
	14) Kupton obligimet e mjekut familjar	_____	_____
<b>Vlerat profesionale</b>	15) Posedon dhe aplikon parime etike	_____	_____
	16) Ruan shëndetin e vet fizik dhe mental	_____	_____
	17) Pranon përgjegjësi adekuate	_____	_____
<b>Rritja personale dhe profesionale</b>	18) I aftë t'i identifikojë përparësitë dhe mangësit e punës së vet	_____	_____
	19) Planifikon mësimin (dëshmon)	_____	_____
<b>Rezultati i përgjith. i vlerësuesit</b> 1=ende jo kompetent    2=kompetent    3=kompetent+			

Vlerësimi i SHKATHTËSIVE në mjekësi familjare		Data Vetë (1-3)	Data Mbikqyrësi (1-3)
<b>Nënshkrimi i Specializantit :</b>	_____	<b>Data:</b>	_____
<b>Nënshkrimi i mbikqyrësit klinik:</b>	_____	<b>Data:</b>	_____


**Rasti 1**




**Rasti 3**




**Rasti 2**




**Rasti 4**




**Rasti 5**




**Rasti 7**



**Rasti 6**



**Rasti 8**



**Rasti 9**




**Rasti 10**



*- Për më shumë raste përdor fletë shtesë dhe bashkangjiti Ditarit tënd*

**Komenti i Trajnuesit (Mentorit Klinik)**



***Vlerësimi i Modulit: A , B , C , apo D***  
***Nënshkrimi i Trajnuesit (Mentorit Klinik)***

---

***Data / Muaji / Viti***

--	--	--	--	--	--	--

**v.v.**

# Shëndeti publik

*Moduli 2:*

Emri: \_\_\_\_\_

Data:   filloi: \_\_\_\_\_ përfundoi: \_\_\_\_\_

***Ky është moduli i dytë në programin e edukimit specialistik pasdiplomik tre vjeçar.***

***Moduli i shëndetit publik do të zgjatë dy muaj.***

## ***Roli i mjekut familjar***

Qendrat e mjekësisë familjare kanë një rol të rëndësishëm në promovimin e shëndetit. Është me rëndësi që mjekët familjarë të shfrytëzojnë mundësinë dhe të integrojnë promovimin shëndetësor në kuadër të praktikës së tyre të përditshme pasi që janë kontakti i parë me pacientët. Mjekët familjarë i shohin pacientët e njejtë me vite të tëra dhe kanë një pasqyrim se si shëndeti i tyre ndikon në jetën e përditshme. Këta faktorë ndihmojnë në tejkalimin e barrierave në mes të mjekut dhe klientëve të tyre si dhe në arrijen e një komunikimi më të mirë në mes tyre.

## ***Qëllimi i formulimit të këtij planprogrami***

Formulimi i këtij planprogrami është të kuptohet rëndësia e inkuorporimit të shëndetit publik në kuadër të mjekësisë familjare dhe të kuptohen se cilat janë shërbimet të cilat mund t'i ofroj mjeku familjar në lidhje me shëndetin publik, gegjësisht promovimin shëndetësor dhe rëndësinë e tij.

## Objektivat mësimore

Objektiv kryesor i këtij moduli është që t'ju mundësohet specializantëve t'i integrojnë konceptet dhe principet kryesore të shëndetit publik në rolet e tyre si profesionistë. Specializantët do të inkurajohen që të kuptojnë rëndësinë e promovimit shëndetësor, organizimin e programeve të skreningut dhe edukimin shëndetësor të popullatës.

Specializantët do të jenë të aftë të kuptojnë:

- Teorinë e promovimit shëndetësor (konceptet e shëndetit, ndikimet në shëndet, definimin e promovimit shëndetësor)
- Strategjitë dhe metodat e promovimit shëndetësor
  - partnershipet për shëndet
  - puna në kuadër të shëndetit publik
  - puna në komunitete dhe zhvillimi i tyre
  - promovimi shëndetësor në vendet e punës
  - promovimi shëndetësor në kuadër të kujdesit parësor shëndetësor
  - vlerësimi i nevojave shëndetësore
  - planifikimi i intervenimeve të promovimit shëndetësor
  - evaluimi në promovimin shëndetësor
- Masat parandaluese të sëmundjeve kronike
- Organizimin dhe zbatimin e imunizimit
- Planifikimin, organizimin dhe përpilimin e organeve të skreningut

## Shëndeti i popullatës dhe konteksti i mjekësisë familjare

Specializantët të cilët janë të aftësuar do të:

- Kenë njohuri mbi demografinë, epidemiologjinë, problemet e shëndetit publik dhe nevojat shëndetësore të grupeve speciale
- Jenë të vetëdijshëm mbi modelet dhe mbizotrimin e sëmundjeve dhe të marrin pjesë në strategjitë preventive të popullatës
- Kenë një vlerësim kritik ndaj ndikimit në shëndet të pacientit të prapavisë së tyre socio-politike, ekonomike, punës, shpirtërore dhe kulturore si dhe nevojat e tyre dhe në marrëdhëniet me familjet e tyre dhe personave të tjerë të rëndësishëm.
- Posedojnë aftësi në mbrojtjen dhe në përdorimin e resurseve të komunitetit.

- Çmojnë rëndësinë e shëndetit publik dhe perspektivën në mjekësi familjare

## Minimumi i shkathtësive dhe njohurive esenciale

Specializanti do të jetë i aftë të:

- Vendos dhe të ketë parasyshë prapavijën dhe nevojat socio-politike, ekonomike, punuese, kulturore të pacientit si dhe në marrëdhëniet me familjet e tyre dhe personave të tjerë të rëndësishëm në lidhje me shëndetin e tyre
- Kuptoj dhe të përgjigjet për nevojat dhe karakteristikat e shëndetit publik duke përfshirë preventivën e sëmundjeve, ngritjen e kujdesit shëndetësor
- Përdor përvojën e punës për të asistuar në shëndetin e komunitetit lokal, regional dhe nacional duke përfshirë:

- Pjesëmarrjen në preventivën e komunitetit dhe në strategjitë e edukimit shëndetësor

- Qasjen në shërbimet shëndetësore në dispozicion

- Lidhjen me mjekë familjarë, organizata të mjekëve familjarë dhe shërbimeve tjera shëndetësore

- Pjesëmarrjen në sistemin publik shëndetësor (psh. sëmundjeve që duhet të regjistrohen dhe çështjeve tjera të ambientit rrethues)

Të jetë i aftë të:

- Kuptoj dhe shfrytëzoj sistemin e kujdesit shëndetësor të Kosovës për interesat e pacientëve të tyre
- Kuptoj promovimin e shëndetit publik dhe qasjet prevenuese




**Rasti 1**




**Rasti 3**



**Rasti 2**



**Rasti 4**




**Rasti 5**




**Rasti 7**




**Rasti 6**




**Rasti 8**



**Rasti 9**




**Rasti 10**



*- Për më shumë raste përdor fletë shtesë dhe bashkangjiti Ditarit tënd*

**Komenti i Trajnuesit (Mentorit Klinik)**



***Vlerësimi i Modulit: A , B , C , apo D***  
***Nënshkrimi i Trajnuesit (Mentorit Klinik)***

---

***Data / Muaji / Viti***

--	--	--	--	--	--	--

v.v.

# Emergjencat më të Shpeshta në Kujdesin Parësor Shëndetësor - KPSH

*Moduli 3:*

Emri: \_\_\_\_\_

Data: filloi: \_\_\_\_\_ përfundoi: \_\_\_\_\_

*Këtu kërkohen katër muaj trajnimi për të përvetësuar përvojë të mjaftushme për t'u bërë praktikues i pavarur. Ju do të duhej të mbani ushtrime në spital (një herë në javë nga ora: 07-15.00) dhe në Qendrën tuaj të Mjekësisë Familjare (dy herë në javë) dhe Qendrën tuaj Trajnuese të Mjekësisë Familjare (një herë në javë). Gjithësesi edhe Ligjëratën Qëndrore (një herë në javë) në QZHMFK. Ky Modul zgjatë katër (4) muaj.*

*Ju duhet të jeni kompetent për:*

- Të kryer një spektër të shkathtësive themelore (dhe të avancuara)
- T'i menaxhuar emergjencat

*Ju nevojiten njohuritë*

- Mbi protokolet dhe procedurat emerxhente lokale

***Këtu janë dhënë disa objektiva si përmbledhje të bazuara në sferat e planprogramit. Shfrytëzoni ditarin e punës në fund si mjet për regjistrimin e përvojës suaj dhe për të caktuar objektivat tuaja personale të bazuara në pacientët që i takoni.***

### ***Shkathtësitë e komunikimit dhe raporti mjek-pacient***

- Shfrytëzon edukimin për pacientë për të ndihmuar në zvogëlimin e numrit dhe të frekuencës së paraqitjeve të parandalueshme
- Demonstron shkathtësi konsultimi adekuate për menaxhimin e sëmundjes akute dhe traumës së paraqitur

### ***Njohuritë dhe shkathtësitë e aplikuara profesionale Përvetësimi i:***

- Shkathtësive esenciale të mbajtjes së avancuar në jetë
- Shkathtësive të vendim-marrjes për menaxhimin e sëmundjes akute dhe traumave të paraqitura

### ***Diagnostikimi dhe menaxhimi i:***

- Sëmundjeve më të shpeshta dhe të rëndësishme akute serioze dhe gjendjeve traumatike

### ***Njohja me***

- Paraqitjet e shpeshta akute dhe traumatike
- Procedurat esenciale dhe shkathtësitë për menaxhimin e sëmundjes akute dhe të traumës
- Referimin adekuat në kujdesin sekondar dhe terciar
- Nivelin adekuat të kujdesit në reanimim dhe stabilizim të pacientit për transfer

### ***Prioritarizimi i***

- detyrave për menaxhimin e sëmundjes akute dhe traumës në mënyrë efektive

### ***Dimensionet organizative dhe legale***

- Menaxhimi i pëlqimit për pacientët me shfaqje akute (p.sh. transfuzioni i gjakut)
- Theksimi i procedurave të pëlqimit në kujdesin emergjent
- Integrimi i resurseve të komunitetit për kujdesin
- Sigurimi i dispozicionit të pajisjes dhe barnave emergjente adekuate
- Theksimi i përgjegjësive ligjore dhe të raportimit (p.sh. për kumtimin e vdekjes, autopsia).

***Këtu (në faqen tjetër) është një listë artikujsh për ju dhe mentorin/trajnuesin tuaj për të vlerësuar prej 1 deri 3 (3 = kompetent). Në fillim jepni vetë-vlerësimin tuaj. Shënoni datën kur keni observuar dhe punuar (kryer) procedurën. Trajnuesi juaj ju vlerëson në fund, por ju mund të dëshironi të diskutoni përvojën tuaj në gjysëm të modulit.***




**Rasti 1**




**Rasti 3**




**Rasti 2**




**Rasti 4**




**Rasti 5**




**Rasti 7**



**Rasti 6**



**Rasti 8**



**Rasti 9**

**Rasti 10**

*- Për më shumë raste përdor fletë shtesë dhe bashkangjiti Ditarit tënd*

**Komenti i Trajnuesit (Mentorit Klinik)**

***Vlerësimi i Modulit: A , B , C , apo D***  
***Nënshkrimi i Trajnuesit (Mentorit Klinik)***

---

***Data / Muaji / Viti***

--	--	--	--	--	--	--	--

**v.v.**

## *Shëndeti i fëmijëve dhe adoleshentëve*

*Moduli 4:*

Emri: \_\_\_\_\_

Data: filloi: \_\_\_\_\_ përfundoi: \_\_\_\_\_

*Mjekët familjarë shohin shumicën e popullsisë në vit. Pacientët nën një vjeç përbëjnë gati një të katërtën e të gjitha konsultimeve të mjekëve familjarë.*

*Ekziston një mundësi për mjekët familjarë të trajnuar dhe të motivuar mirë që të shtojnë shëndetin e komunitetit përmes fëmijëve dhe adoleshentëve të tij.*

*Një strategji për përparimin mund të përfshijë konsideratat në vijim për reduktimin e morbiditetit dhe mortalitetit në mesin e fëmijëve dhe do të duhej të kërkonte mundësi për eksperiencë në këto fusha të këtij moduli 4 mujorë.*

- **Mortaliteti i parandalueshëm** (p.sh. lëndimi, aksidenti, vetëvrasja, çrregullimet gjenetike)
- **Paaftësia**, duke përfshirë reduktimet në shfaqjen e paaftësive të reja dhe ndikimit të paaftësisë së krijuar (duke përfshirë abnormalitetin kongjenital, peshën e vogël të lindjes, prematuritetin, sëmundjen kronike, paaftësinë intelektuale, paaftësinë fizike dhe çrregullimet e mësimit)

- Sëmundje vaksinë-preventabile
- Ndikimi i gjendjeve që shfaqen në moshë të rritur të cilat manifestimet e herëshme i kanë në fëmijëri apo adoleshencë (p.sh. diabeti, sëmundjet kardiovaskulare, shumë kancere dhe çrregullime mentale, pasojat e ushqimit të dobët, problemet e mënyrës së jetesës si abuzimi i substancave dhe aktiviteti seksual i pambrojtur)
- **Familja dhe funksionimi social** (relevante në çdo konsultim që përfshinë fëmijën apo adoleshentin)

***Këtu janë dhënë disa objektiva të bazuara në sferat e planprogramit. Shfrytëzoni ditarin reflektiv në fund të këtij ditari të punës si mjet për regjistrimin e përvojës suaj dhe për caktimin e objektivave personale tuaja të bazuara në pacientët që ju i shihni.***

***Shkathësitë e komunikimit dhe raporti mjek-pacient***  
***Hapja, besimi dhe cilësia e komunikimit në raportet ndërmjet mjekut familjar, pacientit dhe familjes janë kritike për përmirësimin e rezultateve shëndetësore. Komunikimi i mirë gjithashtu e shton vetëbesimin e prindit dhe rritjen e vazhdueshme personale të mjekut dhe të pacientit.***

- Marrja adekuatë e anamnezës, duke njohur anksozitetet e caktuara të prindërve më fëmijë të sëmurë dhe duke dalluar ekspertizën e tyre si observues i afërt i fëmijës dhe sëmundjes
- Shfrytëzimi i komunikimit efektiv për angazhim dhe ekzaminimin e fëmijës, duke vërejtur vetëdijen e fëmijës, interesimin dhe përgjigjen
- Negocimi i një plani efektiv të menaxhimit i cili cakton pritje reale ndërmjet prindit, pacientit dhe mjekut
- Caktimi adekuat i nivelit të kuptimit të prindit mbi gjenjen, indikatorët dhe mekanizmat e përcjelljes (p.sh. udhërrëfyesit e praktikës);

- Shfrytëzimi i raportit terapeutik për promovimin e vetëbesimit dhe shkathësitë të prindit (p.sh. edukimi, risigurimi, përcjellja).

***Njohuritë dhe shkathësitë e aplikuara profesionale***  
***Shumë probleme që shfaqen janë në përputhje me mundësinë e sëmundjes serioze (p.sh. ethe, vjellje, dhimbje abdominale). Disa probleme kërkojnë dallimin e menjëhershëm dhe trajtimin (p.sh. obstruksioni i rrugëve të sipërme të frymëmarrjes me pengesë). Familjet shpesh herë paraqiten duke kërkuar ilaçe mjekësore për problemet të cilat nuk janë përmirësuar përmes intervenimeve fizik. Menaxhimi i kujdesshëm kërkohet për t'iu shmangur barnave të panevojshme.***

- Kuptimi i spektrit të normalitetit të fëmijët dhe adoleshentët dhe monitorimi i rritjes dhe zhvillimit
- Asistimi me problemet e zakonshme të foshnjërisë
- Menaxhimi i gjendjeve të zakonshme/të rëndësishme të fëmijëve dhe adoleshentëve, në veçanti atyre të cilat mund të shkaktojnë mortalitetin apo morbiditetin
- Procedura klinike praktike relevante për fëmijëri dhe adoleshencë
- Shfrytëzimi i sigurtë i agjentëve farmakologjik, me aplikimin e kujdesit paraprak relevant për shtatzëni, laktacion, foshnjëri dhe adoleshencë
- Kosto dhe bindja me trajtimin, çështje këto të përshkrimit të recetave për adoleshentë
- Identifikimi dhe planifikimi i menaxhimit për fëmijët dhe adoleshentët në rrezik nga keqtrajtimi, dhuna, neglizhenca, pastreha apo lëndimet jo aksidentale
- Identifikimi i indikatorëve të hershëm të sjelljeve “të rrezikshme” të adoleshentëve

- Diskutimi i mëtim të zakonshëm drejtë pavarësisë dhe çështjet e rëndësishme për adoleshentët (p.sh. agjensionet resurse të adoleshentëve, seksualiteti)
- Përshtatja e stilit të konsultimit dhe plani i menaxhimit për t'u përgjigjur në nevojat e fëmijëve dhe adoleshentëve
- Konturimi i efektit të dinamikës së familjes në shprehjet e fëmijës (p.sh. punësi, statusi socio-ekonomik)
- Kuptimi i rëndësisë së tjetërsimit nga shkolla si çështje e madhe shëndetësore (p.sh. ngacnimi, depresioni, mësimi, vetëbesimi).

### ***Shëndeti i popullatës dhe konteksti i mjekësisë familjare***

- Kalendarët e vaksinimeve dhe prevalenca e sëmundjeve vaksinë-preventabile dhe diskutimi i vaksinimit oportunistik
- Regjistri i prindit për të ndihmuar promovimin shëndetësor, vrojtimit e zhvillimit dhe komunikimin
- Rëndësia e veprimit inter-sektorial për shëndetin e fëmijëve dhe adoleshentëve, roli i hulumtimit dhe partneritetet e reja potenciale me punëtorët shëndetësor dhe agjensionet/shërbimet burimore

### ***Roli profesional dhe etik***

***Vlerat profesionale dhe etike i paraprijnë çdo vendimi klinik. Madje edhe shfrytëzimi i fjalës pacient në vend të “klinet” apo “konsumator” nënkupton një raport të privilegjuar, i cili tërheq me vete përgjegjësi speciale.***

- Nxjerrja e kënaqësisë personale dhe rritja prej ndihmës së dhënë fëmijëve, adoleshentëve dhe familjarëve të tyre
- Përvetësimi i shkathtësive të mësimdhënies, hulumtimit dhe avokimit të synuar drejtë përmirësimit të mirëqenjes së fëmijëve dhe adoleshentëve
- Puna efektive me rrjetat lokale dhe shërbimet e fëmijëve dhe rinisë

### ***Dimensionet organizative dhe legale***

***Promovimi efektiv shëndetësor, menaxhimi i emergjencave dhe minimizimi i morbiditetit të parandalushëm, të gjitha këto varen në sisteme dhe procedura të praktikës së mirë. Intencat më të mira mund të dështojnë nga organizimi i dobët. Rishqyrtimi i kujdesshëm dhe përcjellja janë kryesoret për strategjinë e menaxhimit gjatë kujdesit për fëmijët dhe adoleshentët. Për ata me probleme potenciale serioze, strategjitë dhe udhërrëfyesit specifik janë esenciale.***

- Nënkuptimet ligjore të keqtrajtit apo neglizhencës së dyshuar emocionale, fizike dhe seksuale të fëmijëve/adoleshentëve dhe parakushtet e domosdoshme për raportim aty ku janë prezente
- Diskutimi se si çështjet në vijim ndërliken me fëmijët dhe adoleshentët:
- Të drejtat individuale; çështjet e shoqëruesve (kujdestarëve); moshë e pëlqimit; pëlqimi i informuar
- HIV/AIDS; privatiteti; fuqia e mbrojtësve mbi të drejtat e të miturve.

***Këtu (në faqen tjetër) është dhënë një listë artikujsh për ju dhe mentorin/trajnesin tuaj. Kjo listë NUK ËSHTË KOMPLETE. Shënoni datën kur keni observuar gjendjen apo keni kryer procedurën. Jepni vetë-vlerësimin e juaj në fillim. Trajnuesi i juaj ju vlerëson në fund, por ju mund të dëshironi të diskutoni përvojën tuaj në mes të modulit***

Shfrytëzoni këtë klasifikim për vetë-vlerësim në gjysëm të këtij moduli

Shëndeti i fëmijëve dhe adoleshentëve	Rezult Start (1-3)	Data Obser vimit	Data Trajtim it	Rezult Trajnues (1-3)
1) Pesha e ultë e lindjes				
2) Ekzaminimi i të posalindurit				
3) Reanimimi i të posalindurit				
4) Ushqimi enteral/parenteral				
5) Trajtimi i helmimit				
6) Obstruksioni i rrugëve të sipërme të frymëmarrjes				
7) Diagnoza diferenciale e etheve				
a) vjellja				
b) dhimbja abdominale				
c) verdhëza				
d) ekzantemat				
8) Gastroenteriti				
9) Infeksioni i traktit urinar				
10) Infeksioni i sipërm respirator				
11) Bronkioliti				
12) Astma				
13) Ethet reumatike				
14) Sëmundja kongjenitale e zemrës				
15) Abnormalitetet tjera kongjenitale				
16) Sëmundjet metabolike				
17) Morbus coeliacus				
18) Leukemia limfoblastike akute				
19) Aksidenti në shtëpi				
20) Keqtrajtimi, dhuna, neglizhenca				
21) Pastreha				
22) Malnutricioni				
23) Lëndimi jo aksidental, vetëvrasja				
24) Vetë-gjymtimi				
25) Keqpërsorimi i drogave				
26) Shtatzënia adoleshente dhe seksi pa mbrojtje				
27) Çrregullimet e ngrënies				
28) Depresioni				
29) Çrregullimet e mësimit				
30) Paafhtësitë fizike				
31) Hapat dhe ekzaminimi i zhvillimit				
32) Këshillimi i përgjithshëm				
33) Shfrytëzimi i udhërrëfyesëve të praktikës				


**Rasti 1**




**Rasti 3**




**Rasti 2**




**Rasti 4**




**Rasti 5**




**Rasti 7**



**Rasti 6**



**Rasti 8**



**Rasti 9**

**Rasti 10**

*- Për më shumë raste përdor fletë shtesë dhe bashkangjiti Ditarit tënd*

**Komenti i Trajnuesit (Mentorit Klinik)**

***Vlerësimi i Modullit: A , B , C , apo D***  
***Nënshkrimi i Trajnuesit (Mentorit Klinik)***

---

***Data / Muaji / Viti***

--	--	--	--	--	--	--	--

**v.v.**

## Sëmundjet kronike

*Moduli 5:*

Emri: \_\_\_\_\_

Data: filloi: \_\_\_\_\_ përfundoi: \_\_\_\_\_

*Mirë se erdhët në këtë modul në të cilin ju do t'i kaloni gjashtë muaj duke i zhvilluar njohuritë, shkathtësitë dhe qëndrimet tuaja për kujdesin e pacientëve me sëmundje kronike. Mjekësia familjare është në pozitë të mirë për ofrimin e vazhdimësisë së kujdesit dhe të qasjes ekipe në përkrahjen e pacientit gjatë zhvillimit të strategjive të përballjes për vetë-kujdes dhe prevencës sekondare.*

*'Sëmundja kronike është prezencë, akumulim apo latencë irreversible e gjendjeve të sëmuara apo të dëmtimeve të cilat përfshijnë ambientin e përgjithshëm njerëzor për kujdes përkrahës, mirëmbajtje të funksionit dhe parandalim të paaftësisë së mëtutjeshme'*

*Shprehja 'gjendje kronike' interpretohet se përfshinë çdo formë të sëmundjes kronike, sëmundjes apo kompleksit të simptomave apo paaftësisë, duke përfshirë edhe sëmundjen terminale. "Kronik" d.m.th. "gjatë kohës" andaj edhe nevoja për kujdesin e vazhdueshëm. Shprehja "moshëndet" në përgjithësi shfrytëzohet për përshkrimin se çfarë përjeton pacienti (subjektiv). "Sëmundja" është shprehje më objektive.*

***Popullsia e Kosovës është relativisht e re. Sidoqoftë, do të ketë një prevalencë të shtuar të problemeve shëndetësore kronike 50 viteve të ardhshme. Mjekët familjarë do të jenë në pozitën më të mirë për ofrimin e kujdesit kronik, synimi primar i të cilit është shtyrerja e fillimit të sëmundjes simptomatike dhe zvogëlimi i morbiditetit dhe për ofrimin e përkrahjes e cila përfshinë menaxhimin e sëmundjes terminale dhe ofrimin e qetësimit të dhimbjeve.***

***Ju do të vazhdoni të hulumtoni***

- Punën ekipore multidisciplinare
- Qasjet ndaj personit në tërësi
- Prevension
- Konsultimi për partneritet me pacientin

***Ky modul do t'iu ndihmojë hulumtimin e qëndrimeve tuaja ndaj:***

- Lidhjeve ndërmjet sëmundjeve kronike, mosshëndetit, paaftësisë dhe sëmundjes terminale
- Efekteve të morbiditetit në funksionin e individit, familjes dhe shoqërisë
- Mënyrat e edukimit dhe inkurajimit të kujdesuesëve

***Ju do të duhet të zhvilloni shkathtësitë për aplikimin e njohurive për***

- Diagnostikimin e gjendjeve të reja gjatë menaxhimit të ekzistueses
- Dallimin e shenjave dhe simptomeve të hershme që kërkojnë dryshim në menaxhimin klinik
- Komunikimin efektiv të nevojës për parandlimin sekondar të komplikimeve

- Referimin adekuat për këshillë dhe trajtim specialistik
- Prioritarizimin e gjendjeve kërcënuese për jetën
- Menaxhimin e dhembjes
- Përkrahjen e pacientëve në vdekje dhe kujdesuesit e tyre

***Mos harroni të kërkonti ndihmë dhe këshilla. Ju jeni pjesë e ekipit dhe keni mundësinë dhe përgjegjësinë për të kontribuar në rishqyrtimin klinik të pacientëve dhe të spitalit e të qendrës së mjekësisë familjare në të cilën punoni. Kjo përfshinë edhe sigurimin e cilësisë.***

***Këtu janë dhënë disa objektiva të bazuara në sferat e planprogramit. Shfrytëzoni ditarin reflektiv në fund të këtij ditari të punës si mjet për regjistrimin e përvojës suaj dhe për caktimin e objektivave personale tuaja të bazuara në pacientët që ju i shihni. Sjelljet mësimore janë në italiqe:***

***Shkathtësitë e komunikimit dhe raporti mjek-pacient***

- *Shfrytëzoni qasjen e përqëndruar në pacientin, përkrahëse dhe zhvilloni raporte afat gjatë të cilat u ndihmojnë pacientëve me gjendje kronike për të marrë sa më shumë përgjegjësi për fatin e tyre*
- *Jini reagues dhe bashkëndjënës ndaj fluktuacioneve në gjendjen fizike dhe mentale të pacientëve me gjendje kronike dhe kuptoni që sëmundja terminale është një gjendje komplekse me nevoja fizike, psikologjike, emocionale dhe shpirtërore*
- *Negoconi planet menaxhuese për maksimalizimin e mirëqenjes së pacientit, autonominë dhe kontrollën personal mbi jetën e tyre bashkë me nevojat, dëshirat dhe besimet e tyre*
- *Ruani raporte afatgjate, përkrahëse me pacientët të cilët dështojnë të përgjigjen apo të bashkëpunojnë me menaxhimin mjekësor*

- **Dalloni** rëndësinë e njësisë familjare dhe strukturës dhe ndikimin e sëmundjes në familje

### ***Njohuritë dhe shkathhtësitë e aplikuara profesionale***

#### ***Konturimi i:***

- Rrjedhës së sëmundjes, prognozës, trajtimit dhe menaxhimit të sëmundjeve të shpeshta kronike
- Anatomisë relevante, fiziologjisë, patologjisë dhe psikologjisë për menaxhim
- Barrierave për përmirësimin e bashkëpunimit të pacientit në trajtim me gjendje kronike dhe strategjive për tejkalimin e këtyre barrierave
- *Vlerësimi* të funksionit dhe paaftësisë fizik, psikologjik dhe social
- **praktikimi** i menaxhimit të pacientit të bazuar në dëshmi dhe parashikimi i problemeve të shkaktuara qoftë nga sëmundja apo trajtimi i tyre
- **monitorimi** i menaxhimit të rastit, koordinimit të kujdesit dhe advokimit, kryerja e procedurave adekuata mjekësore
- **procesin e përcjelljes dhe të rishqyrtimit** përmes protokoleve dhe udhërrëfyesëve, qeverisjes klinike dhe auditit

### ***Shëndeti i popullatës dhe konteksti i mjekësisë familjare***

- **përdorimi** i resurseve të ndryshme shëndetësore dhe komunitare në dispozicion të cilat ndihmojnë njerëzit me gjendje kronike/terminale
- **ndihma dhe përkrahja** e pacientëve për t'i tejkaluar barrierat e ndërlidhura me gjendjen e tyre kronike/terminale (duke përfshirë edhe paragjykimin, stericizmin, stereotipinë sociale dhe normat kulturore)
- **skreningu** adekuat për identifikimin e individëve asimptomatik me gjendje kronike apo malinje

- **vetëdijësimi mbi** problemet kronike shëndetësore të grupeve specifike të komunitetit;

### ***Roli profesional dhe etik***

- **demonstrimi** i atributëve dhe sjelljes drejtë pacientëve me gjendje kronike/terminale adekuat me rolin e Mjekut Familjarë
- **implementimi** i metodave për monitorimin dhe vlerësimin e cilësisë
- **praktikimi** i pëlqimit, privatitetit, autonomisë, legjitimitetit
- **vizitat** e pacientëve në shtëpi dhe diskutimi i rëndësisë së këtij shërbimi për menaxhimin e gjendjeve kronike dhe për kujdesin e atyre në vdekje.

### ***Dimensioet organizative dhe legale***

#### ***Shfrytëzimi i sistemeve të regjistrave mjekësore dhe sistemeve informative bashkohore***

- për kujdesjen për pacientë kronik/terminal
- për ndihmën efektive për parandalimin, diagnozën dhe menaxhimin

#### ***menaxhimi i kohës***

- duke përfillur kërkesat për kohë dhe përpjekjet gjatë menaxhimit të pacientëve të sëmurë kronik/terminal,

### ***njohja e aspekteve ligjore dhe avokate të gjendjeve kronike dhe atyre në vdekje.***

#### ***Caktoni planin mësimor tuaj për këtë modul duke kërkuar metodat për:***

- **zhvillimin e perspektivës longitudinale.** Kjo nënkupton *përvjelljen* e të gjithë pacientëve për një periudhë të zgjatur kohore. Rishqyrtimi periodik dhe sistematik mund të lidhet me aktivitetet menaxhuese specifike për sëmundjen (p.sh. klinika diabetike; planet e përcaktuara të kujdesit; procesi i përgjithshëm si p.sh. përshkrimi i përsëritur i recetës)
- **qasja e bazuar në rastin.** Është e përshtatshme për mësimin e aspekteve të

përgjithshme dhe specifike të gjendjeve kronike. *Regjistroni përvjelljet tuaja*

- **sigurimi i cilësisë.** Do të duhej të përfundoni së paku një **audit**

### ***Metodat për të cilat mund të vlerësoheni përfshijnë***

- natyra dhe shkalla e gjendjeve kronike/terminale
- individit në qendër të sëmundjes kronike/terminale
- aspektet psiko-sociale të gjendjeve kronike/terminale
- gjendjet kronike/terminale dhe puna
- menaxhimii gjendjeve kronike/terminale
- parandalimi i gjendjeve kronike/terminale
- auditit i kujdesit klinik i së paku një sëmundjeje kronike

***Andaj ne sygjerojmë që ju vazhdimisht të shenoni në ditarin reflektiv dhe ta shfrytëzoni vazhdimisht për të reflektuar mbi kontaktet tuaja me pacientë dhe të diskutoni me kolegët dhe trajnuesit. Ky modul është një hyrje në problemet kryesore të Mjekësisë familjare!***

***Këtu (në faqen tjetër) është një listë artikujsh për ju dhe mentorin/trajnuesin tuaj për të vlerësuar prej 1 deri në 3 (3=kompetent). Në fillim ju jepni vlerësimin tuaj. Shenoni datën e observimit të gjendjeve dhe kur keni kryer procedurën. Trajnuesi juaj ju vlerëson në fund, por ju mund të dëshironi të diskutoni përvojën tuaj në gjysëm të modulit. Shtoni në ditarin tuaj me pacientët që ilustrojnë shumicën e këtyre.***

<b>Shfrytëzoni këtë klasifikim për vetë-vlerësim në gjysëm të këtij moduli</b>				
<b>Sëmundjet kronike</b>	<b>Rezult Start (1-3)</b>	<b>Data Obser vimit</b>	<b>Data Trajtim it</b>	<b>Rezult Trajnues (1-3)</b>
1) klinika diabetike	_____	_____	_____	_____
2) sëmundjet e tiroides	_____	_____	_____	_____
3) sëmundja ishemike e zemrës	_____	_____	_____	_____
4) hipertensioni	_____	_____	_____	_____
5) depresioni kronik	_____	_____	_____	_____
6) qendra për kujdesin paliativ/hospice	_____	_____	_____	_____
7) përcjellja afatgjate efektive	_____	_____	_____	_____
8) rishqyrtimi sistemik periodik	_____	_____	_____	_____
a) certifikimi	_____	_____	_____	_____
b) privatiteti	_____	_____	_____	_____
c) shkrimi i raportit ligjor	_____	_____	_____	_____
d) kërkesat ligjore të përshkrimit dhe refuzimit	_____	_____	_____	_____
e) mosdhënja dhe tërheqja e trajtimit	_____	_____	_____	_____
9) Receta e përsëritur dhe monitorimi i efekteve anësore të p.sh. ACE inhibitorëve	_____	_____	_____	_____
10) Auditimi i regjistrave dhe procedurave p.sh. audit i kujdesit për hipertension	_____	_____	_____	_____
11) Planet e kujdesit	_____	_____	_____	_____

**Rasti 1**



**Rasti 3**




**Rasti 2**




**Rasti 4**




**Rasti 5**




**Rasti 7**



**Rasti 6**



**Rasti 8**



**Rasti 9**

**Rasti 10**

*- Për më shumë raste përdor fletë shtesë dhe bashkangjiti Ditarit tënd*

**Komenti i Trajnuesit (Mentorit Klinik)**

***Vlerësimi i Modulit: A , B , C , apo D***  
***Nënshkrimi i Trajnuesit (Mentorit Klinik)***

---

***Data / Muaji / Viti***

--	--	--	--	--	--	--

**v.v.**

# Shëndeti mental

*Moduli 6:*

Emri: \_\_\_\_\_

Data: filloi: \_\_\_\_\_ përfundoi: \_\_\_\_\_

*Mirë se erdhët në këtë modul i cili kërkon katër muaj trajnimi për të përvetësuar përvojë të mjaftueshme për t'u bërë praktikues i pavarur. Ju do të duhej të kërkonit ushtrime në spital dhe në qendrën tuaj të mjekësisë familjare dhe të kërkonit ndihmë.*

*Kjo deklaratë mëton caktimin e kontekstit:*

*Problemet e shëndetit mental dhe çrregullimet mentale janë vlerësuar se prekin mbi 20% të popullsisë së rritur dhe ndërmjet 10% dhe 15% të adoleshentëve në çdo vit.*

*Vetëm në vitet rishtazi ka qenë një qasje e brengosur për adresimin e çështjes së vetëvrasjes*

*Shëndeti mental është prioritet kryesor. Synimi është që të:-*

- Zvogëlohet humbja e shëndetit, mirëqenjes dhe funksionimit social të shoqëruar me problemet e shëndetit mental dhe çrregullimet mentale
- Zvogëlohet incidenca e vetëvrasjeve në mesin e njerëzve me çrregullime mentale.

*Ju do të jeni të aftë që të eksploroni dhe të përballeni me:*

- Ekipet e kujdesit multi-disciplinar
- Qasjet ndaj personit si tërësi: sociale, kulturore, emocionale, shpirtërore dhe socio-ekonomike
- Streset emocionale të individit, familja dhe ambientet shoqërore të cilat ndikojnë në gjendjen e pacientit dhe/ose rezultatet prej saj

***Mjekët familjarë shpesh janë pika e parë e kontaktit për pacientit që përjetojnë probleme të shëndetit mental.***

***Do t'iu nevojitet trajnim i mjaftueshëm për të qenë të aftë për:***

- Identifikimin e shenjave të hershme paralajmëruese
- Ofrimin e kujdesit adekuat
- Ofrimin e kujdesit të vazhdueshëm (faktor kryesor për trajtimin të suksesshëm)

***Gjithashtu do të keni nevojë për përvetësimin e shkathtësive të negociimit:***

- Për t'i asistuar konsumatorët, kujdesuesit dhe profesionistët e shëndetit mental për përparimin e sistemit të përgjithshëm të kujdesit të tyre mental

***Këtu janë dhënë disa objektiva të bazuara në sferat e planprogramit. Shfrytëzoni ditarin reflektiv në fund të këtij ditari të punës si mjet për regjistrimin e përvojës suaj dhe për caktimin e objektivave personale tuaja të bazuara në pacientët që i takoni ju:***

***Shkathtësitë e komunikimit dhe raporti mjek-pacient***

- *Dallimi dhe vlerësimi* i problemeve të shëndetit mental në statet e hershme të sëmundjes
- *Puna me pacientë*, dinjiteti dhe qëndrimet e tyre, vlerat dhe besimet

- Shfrytëzimi i qasjeve të ndryshme të këshillimit për të ofruar përkrahje
- *Shfrytëzimi i agjencive referuese adekuata* (pikëllimi, stresi inter-personal, pacientët e mlllefosur/frikësuar)
- *Komunikimi efektiv* me pacientë dhe familjarët e tyre, kujdesues dhe ekipet menaxhuese
- Puna si pjesë e ekipit multi-disciplinar në menaxhimin e rastit

***Njohuritë dhe shkathtësitë e aplikuara profesionale***

- *Anamneza mentale adekuata* e cila shton vetëbesimin e tyre
- *Dallimi* i ngjarjeve normale jetësore prej sëmundjes mentale të dukshme
- *Menaxhimi* i njerëzve “*në rrezik*” dhe kuptimi i rëndësisë së intervenimit të hershëm dhe vazhdimësisë së kujdesit
- *Ndihma e pacientët për menaxhimin* dhe shtimin e shkathtësive përballëse të tyre dhe parandalimin e morbiditetit sekondar
- Menaxhimi i krizës së shëndetit mental
- *Koordinimi i kujdesit* në nivelin adekuat për kontekstin
- *Demonstrimi* i shfrytëzimit adekuat të agjentëve psikoterapeutik
- *Theksimi* i parimeve të detoksikimit dhe të ndërprerjes (abstinencës)

***Shëndeti i popullatës dhe konteksti i mjekësisë familjare***

- *Praktikimi* i promovimit të shëndetit mental dhe qasjeve preventive
- *Njohja dhe adresimi* i nevojave të kujdesuesëve, vëllaut/motrës dhe fëmijëve
- *Puna efektive me* resurset komunitare dhe spitalore në dispozicion

## Roli profesional dhe etik

- Vetëdija se si vlerat, qëndrimet dhe besimt tuaja profesional mund të ndikojnë
- Kuptimi i nevojës për ruajtjen e privatitetit
- Adherimi me kufijtë adekuat në raportin mjek-pacient
- Shmangia e sjelljeve të cilat do t'i thenin këta kufinjë

## Dimensionet organizative dhe legale

### Konturimi i:

- Legjislacionit adekuat për shëndetin mental
- Udhërrëfyesëve të politikave mbi qasjen, privatitetin dhe vazhdimësinë e kujdesit
- Strategjive të vetë-kujdesit dhe rrugëve për debriefing .

### Dallimi i:

- Shenjave të depresionit/sëmundjes mentale te kolegët dhe përkrahja/referimi

Shfrytëzoni këtë klasifikim për vetë-vlerësim në gjysëm të këtij moduli		Rezult Start (1-3)	Data Obser vimit	Data Trajtim it	Rezult Trajnues (1-3)
<b>Shëndeti mental</b>					
1)	Pikëllimi ("zija")	_____	_____	_____	_____
2)	Ngarjet e papritura jetësore	_____	_____	_____	_____
3)	Menaxhimi i stresit inter-personal	_____	_____	_____	_____
4)	Efektet e papunësisë	_____	_____	_____	_____
5)	Dhuna	_____	_____	_____	_____
6)	Keqtrajtimi seksual	_____	_____	_____	_____
7)	Sakrifikimi	_____	_____	_____	_____
8)	Çrregullimi i stresit post-traumatik	_____	_____	_____	_____
9)	Familjet disfunktionale	_____	_____	_____	_____
10)	Depresioni	_____	_____	_____	_____
11)	Çrregullimi i disponimit	_____	_____	_____	_____
12)	Rrezuku nga vetëvrasja	_____	_____	_____	_____
13)	Anksioziteti	_____	_____	_____	_____
14)	Çrregullimet e panikut	_____	_____	_____	_____
15)	Çrregullimet e ngrënies	_____	_____	_____	_____
16)	Somatizimi	_____	_____	_____	_____
17)	Shizofrenia	_____	_____	_____	_____
18)	Çrregullimet obsesive kompulsive	_____	_____	_____	_____
19)	Psikoza (shenjat dhe simptomat)	_____	_____	_____	_____
20)	Psikoza (mania/manik-depresive)	_____	_____	_____	_____
21)	HIV psikoza	_____	_____	_____	_____
22)	Pacientët psiko-geriatrik	_____	_____	_____	_____
	a) humbja e memories	_____	_____	_____	_____
	b) demenca Alzheimer	_____	_____	_____	_____
	c) demenca organike	_____	_____	_____	_____
	d) rehabilitimi	_____	_____	_____	_____
23)	Çrregullimet e ndërlidhura me barnat	_____	_____	_____	_____
	a) gjndja toksike konfuzë	_____	_____	_____	_____
24)	Detoksifikimi dhe abstenenca	_____	_____	_____	_____
25)	Shfrytëzimi i agjentëve psikoterapeutik	_____	_____	_____	_____
26)	Vështirësitë për të mësuar:	_____	_____	_____	_____
	a) i rrituri:	_____	_____	_____	_____
	b) fëmija:	_____	_____	_____	_____
27)	Psikologu arsimor	_____	_____	_____	_____
28)	Thyerja e:	_____	_____	_____	_____
	a) privatitetit	_____	_____	_____	_____
	b) kufijve (mjek-pacient)	_____	_____	_____	_____
29)	Terapia familjare	_____	_____	_____	_____
30)	Terapia kognitive e sjelljes	_____	_____	_____	_____
31)	Këshillimi	_____	_____	_____	_____
32)	Tumori i trurit	_____	_____	_____	_____


**Rasti 1**




**Rasti 3**




**Rasti 2**




**Rasti 4**




**Rasti 5**




**Rasti 7**



**Rasti 6**



**Rasti 8**



**Rasti 9**

**Rasti 10**

*- Për më shumë raste përdor fletë shtesë dhe bashkangjiti Ditarit tënd*

**Komenti i Trajnuesit (Mentorit Klinik)**

***Vlerësimi i Modullit: A , B , C , apo D***  
***Nënshkrimi i Trajnuesit (Mentorit Klinik)***

---

***Data / Muaji / Viti***

--	--	--	--	--	--	--	--

**v.v.**

## Shëndeti i meshkujve

*Moduli 7:*

**Emri:** \_\_\_\_\_

**Data:** filloi: \_\_\_\_\_ përfundoi: \_\_\_\_\_

***Ky është moduli i shtatë. Shëndeti i meshkujve zgjatë dy muaj dhe do të angazhoheni me çështjet e:***

- Shkallës më të lartë të vdekshmërisë së meshkujve
- Sjellja e meshkujve në kërkim të shëndetit
- Sjellja e meshkujve në kërkim të ndihmës
- Përcjellja dhe bindja me menaxhimin e sëmundjeve kronike
- Sjellja e varshmërisë
- Lëndimi aksidental dhe vdekja

***Mund të:***

- Asistoni për ngritjen e profilit të shëndetit të meshkujve
- Jeni proaktiv në menaxhimin e tyre
- Mësoni si të sfidoni në mënyrë përkrahëse mënyrën e përkufizimit të maskulinitetit dhe si zhvillohen djemtë

- Mësoni si t'i inkurajoni meshkujt të jenë në kontakt me ndjenjat e tyre në dobi të shëndetit të tyre dhe të shoqërisë

***Këtu janë dhënë disa objektiva të bazuara në sferat e planprogramit. Shfrytëzoni ditarin reflektiv në fund të këtij ditari të punës si mjet për regjistrimin e përvojës suaj dhe për caktimin e objektivave personale tuaja të bazuara në pacientët që ju i shihni.***

### **Shkathtësitë e komunikimit dhe raporti mjek-pacient**

- Dëgjimi dhe kuptimi i nevojave të pacientëve meshkuj
- Shfrytëzimi i bashkëndjenjës dhe strategjive përkrahëse për asistimin e pacientëve meshkuj për t'i shprehur emocionet e tyre dhe për shprehjen e nevojave të tyre
- Zhvillimi i një partneriteti i cili do t'i aftsoj meshkujt që të kuptojnë sjelljet dhe vlerat që mund të kontribuojnë në problemet e tyre shëndetësore.

### **Njohuritë dhe shkathtësitë e aplikuara profesionale**

- Marrja e anamnezës seksuale dhe kryerja e shkathtësive dhe trajtimeve bazike procedurale specifike për gjininë
- Konturimi i IST dhe HIV/AIDS protokoleve të skreningut dhe testimin e antitropave, menaxhimi dhe sistemet përkrahëse për ata që kujdesen për një person në statet përfundimtare të AIDS-it.

### **Shëndeti i popullatës dhe konteksti i mjekësisë familjare**

- Strategjitë për minimizimin e dëmtimit
- Ofrimi i promovimit oportunistik shëndetësor dhe parandalimit të sëmundjeve brenda udhërrëfyesve për skrening
- Inkurajimi i shfrytëzimit të shërbimeve lokale të përkrahjes dhe grupeve për meshkuj

### ***Kuptimi i :***

- Ndikimit të qëndrimeve, vlerave dhe sjelljeve të meshkujve të ndërtuara socialisht mbi shëndetin emocional, psikologjik dhe fizik dhe raportet e tyre sociale
- Efekti i papunësisë, mungesës së të ardhurave, drogave, dhunës dhe alkoolit në familje
- Qëndrimet e komunitetit ndaj dhunës seksuale; karakteristikat e kryesëve dhe mitet lidhur me veprimet e dhunshme
- Përdorimi i drogës
- Përkrahja e ndryshimeve, të cilat kërkohen për ta bërë sistemin e kujdesit shëndetësor dhe mjekësinë familjare më përgjegjëse ndaj nevojave të meshkujve.

### **Roli etik dhe profesional**

- Edukimi i meshkujve për të qenë proaktiv ndaj shëndetit të tyre
- Mbajtja e privatitetit dhe kufinjëve adekuat social në raportin profesional.

### **Dimensionet organizative dhe legale**

- Bindja me udhërrëfyesit profesional, shëndetësor dhe të sigurisë, në veçanti të programeve të vendeve të punës “së rrezikshme”
- Bindja me dispozitat ligjore të cilat mbrojnë personat “në rrezik” (p.sh. urdhërat ndaluese, IST, gjurmimi i kontaktëve)

***Këtu (në faqen tjetër) është dhënë një listë artikujsh për ju dhe mentorin/trajnuenin tuaj. Shenoni datën kur keni observuar gjendjen apo keni kryer procedurën. Jepni vetë-vlerësimin tuaj në fillim. Trajnuesi juaj ju vlerëson në fund, por ju mund të dëshironi të diskutoni përvojën tuaj në mes të modulit***




**Rasti 1**




**Rasti 3**




**Rasti 2**




**Rasti 4**




**Rasti 5**




**Rasti 7**



**Rasti 6**



**Rasti 8**



**Rasti 9**



**Rasti 10**



*- Për më shumë raste përdor fletë shtesë dhe bashkangjiti Ditarit tënd*

**Komenti i Trajnuesit (Mentorit Klinik)**



***Vlerësimi i Modullit: A , B , C , apo D***  
***Nënshkrimi i Trajnuesit (Mentorit Klinik)***

---

***Data / Muaji / Viti***

--	--	--	--	--	--	--	--

V.V

## Shëndeti i femrave

*Moduli 8:*

**Emri:** \_\_\_\_\_

**Data:** filloi: \_\_\_\_\_ përfundoi: \_\_\_\_\_

***Mirë se erdhët në modulën e tetë. Shëndeti i femrave do të zgjatë katër muaj. Në këtë modul mjaft të rëndësishëm do të bëheni:***

- Të përqëndruar në femrat dhe në qasjen e tyre ndaj mjekësisë familjare
- Të vetëdijshëm për nevojën më të shumtë për kujdesin e “personit në tërësi”
- Të orientuar ndaj familjeve
- Të vetëdijshëm për nevojat e ndryshimit të shoqërisë

***Do të keni mundësi për praktikimin e:***

- Shkathësive të komunikimit duke përfshirë edhe dëgjimin dhe ekzaminimin sensitiv
- Punës ekipore duke përfshirë partneritetin me femra
- Parandalimin e sëmundjeve
- Studimin e mortalitetit dhe morbiditetit të lindjes dhe fëmijës
- Monitorimin e sëmundjeve kronike

- Ndërmarrja e skreningut dhe studimi i arsyeshmërisë së tij

***Afro 60% të kontakteve me pacientë të mjekëve familjarë janë femra, shtatzënia dhe lindja janë një pjesë e vogël prej tyre. Femrat janë agjentë kryesorë për përmirësimin e kujdesit shëndetësor në komunitet si edhe në familje. Janë identifikuar faktorët të cilët sygjerojnë që nevojat shëndetësore të femrave dallojnë prej meshkujve:***

- Numër më i madh i grave durojnë status të ultë socio-ekonomik dhe qasje të dobët ndaj strehimit adekuat
- Informatat hulumtuese janë të pakëta
- Roli tradicional kujdesues i grave shpesh si shtesë e punësimit të paguar
- Proporcion më i madh i grave me sëmundje kronike në popullsinë e moshuar të cilët janë të izoluar, mungon mbështetja sociale dhe marrin barna të tepruara
- Dhuna familjare dhe format tjera
- Lidhshmëria me fiziologjinë e grave
- Depresioni, anksoziteti dhe çrregullimet e ngrënies të ndërlidhura me faktorët më lartë

***Këtu janë dhënë disa objektiva të bazuara në sferat e planprogramit. Shfrytëzoni ditarin reflektiv në fund të këtij ditari të punës si mjet për regjistrimin e përvojës suaj dhe për caktimin e objektivave personale tuaja të bazuara në pacientët që ju i shihni.***

### ***Shkathësitë e komunikimit dhe raporti mjek-pacient***

- Strategjitë për lehtësimin e komunikimit me gra të cilat sjellin fëmijët e tyre në konsultimin e tyre

- Ndjeshmëria me gratë lidhur me seksualitetin dhe çështjet intime (në veçanti dallimin e ndikimit të keqtrajtimit seksual në të kaluarën)
- Mos trajtimi me barna i çështjeve të zakonshme
- Çështjet e gjinisë dhe të fuqisë duke përfshirë edhe dinamikën e raportit mjek-pacient

### ***Njohuritë dhe shkathësitë e aplikuara profesionale***

- Shkathësitë e ekzaminimit klinik në lidhje me çështjet e seksualitetit/repruduktive
- Efekti i faktorëve kulturor, social, ekonomik, psikologjik, emocional dhe biologjik në shëndetin e grave
- Njohuria mbi problemet shëndetësore të grave, gjendjet dhe sëmundjet e tyre;
- Kryerja e ekzaminimit të pelvikut kujdesëshëm dhe hollësishëm duke përfshirë edhe strishon e cerviksit, vëmendjen në etiketën profesionale, pëlqimi i pacientit, komforti. Ofrimi i përvojës pozitive, informative për femrën, gjë që i mundëson asaj të kontrolloj procesin dhe përparon vështrimin e saj për vetëveten dhe trupin e saj.

### ***Shëndeti i popullatës dhe konteksti i mjekësisë familjare***

- Parandalimi dhe strategjitë e skreningut relevante për gratë (p.sh. cerviksi, gjiri, antenatal, imunizimi, kanceri) përparësitë dhe mangësitë
- Kontributi për shëndetin e grave në komunitet më të gjerë
- Barazia dhe qasja në informata shëndetësore dhe shërbime për gratë;

### ***Roli profesional dhe etik***

- Si ndikojnë çështjet e menaxhimit të qendrës mjekësore në ofrimin e kujdesit

- Çështjet e shoqëruara me gjininë e mjekut dhe shfrytëzimi i përcjellësve. ***Të referohet për te mjeku femër nëse kërkohet***
- Vlerat, qëndrimet tuaja ndaj çështjeve etike (ndërprerja e shtatzënisë, kontracepcioni për të mitur, pëlqimi, privatiteti, kirurgjia kozmetike)
- Mjekësia familjare në arritjen e nevojave shëndetësore të grave (p.sh. resurset e specializuara, aplikimi i hulumtimeve)
- Komponenta psiko-sociale e shëndetit të grave dhe nevoja, në disa raste, për ofrimin për pacientet gra të përkrahjes shtesë emocionale dhe organizative (p.sh. në lidhje me opsionet për shtatzëni, terapinë zëvendësuese të hormoneve, kancerin e gjirit dhe papunësinë)

### ***Dimensionet organizative dhe legale***

- Mbajtja e regjistrave të pacientëve të cilat janë të sakta, ndihmojnë vazhdimësinë e kujdesit dhe respektojnë privatitetin e pacientit
- Legjislacioni dhe politika (p.sh. regjistri i strishos cervikale, skreningu për kancer të gjirit, kushtet e raportimit për dhunën shtëpiake dhe seksuale).

***Këtu (në faqen tjetër) është dhënë një listë artikujsh për ju dhe mentorin/trajnuesin tuaj. Shënoni datën kur keni observuar gjendjen apo keni kryer procedurën. Jepni vetë-vlerësimin tuaj në fillim. Trajnuesi juaj ju vlerëson në fund, por ju mund të dëshironi të diskutoni përvojën tuaj në mes të modulit.***

Shfrytëzoni këtë klasifikim për vetë-vlerësim në gjysëm të këtij moduli

Shëndeti i femrave	Rezult Start (1-3)	Data Obser vimit	Data Trajtim it	Rezult Trajnues (1-3)
1) Jo fertiliteti:				
a) Femëror				
b) Mashkullor				
2) Këshillimi para shtatzanisë				
3) Kujdesi i përbashkët antenatal				
4) Receptura në shtatzëni				
5) Kontracepcioni oral				
6) Metodat penguese:				
a) Intrauterine				
b) Për të mitur				
7) Menaxhimi i menorragjisë				
8) Diagnoza e sekretit vaginal				
9) Ekzaminimi i pelvikut				
10) Strishoja cervikale				
11) Ndërprerja e shtatëzanisë				
12) Menaxhimi i fertilitetit në mjekësi familjare				
13) Çështjet e menopauzës				
14) Dhembja kronike në pelvik				
15) Inkontinenca urinare				
16) Infeksioni urinar				
17) Infeksionet seksuale transmise				
18) HIV protokolet				
19) Ekzaminimi i gjirit dhe këshillimi				
a) Kanceri				
20) Kanceri i pelvikut				
21) Referimi në shërbimet lokale të përkrashjes				
22) Çështja e privatitetit				
23) Dhuna shtëpiake				
24) Shtatëzënia e padëshiruar				

**Rasti 1**



**Rasti 3**




**Rasti 2**




**Rasti 4**




**Rasti 5**




**Rasti 7**



**Rasti 6**



**Rasti 8**



**Rasti 9**

**Rasti 10**

*- Për më shumë raste përdor fletë shtesë dhe bashkangjiti Ditarit tënd*

**Komenti i Trajnuesit (Mentorit Klinik)**

***Vlerësimi i Modullit: A , B , C , apo D***  
***Nënshkrimi i Trajnuesit (Mentorit Klinik)***

---

***Data / Muaji / Viti***

--	--	--	--	--	--	--	--

**v.v.**

## *Shëndeti i të moshuarve*

*Moduli 9:*

**Emri:** \_\_\_\_\_

**Data:** filloi: \_\_\_\_\_ përfundoi: \_\_\_\_\_

***Mirë se erdhët në modulën mbi shëndetin e të moshuarve (Geriatra) i cili zgjatë dy muaj ku ju do të keni mundësinë të:***

- Përsëritni mjekësinë familjare të të rriturve
- Perfeksiononi shkathtësitë e komunikimit
